

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Misin Frangu dhe zyrtaren ligjore Arbelinda Tahiri, në çështjen e inicuar me padinë e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë, Rr."Lidhja e Pejës" p.n., Magj. Prishtinë - Fushë-Kosovë, kundër të paditurit [REDACTED] nga Ferizaj, Rr. [REDACTED] p.n., të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm avokat [REDACTED] nga Ferizaj, për rimbursim dëmi, në seancën e mbajtur me datë 23.01.2018 merr këtë:

AKTGJYKIM

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë dhe **DETYROHET** i padituri [REDACTED] nga Ferizaj, që paditëses t'ia paguan shumën prej 1,639.00 € (njëmijë e gjashtëqind e tridhjetë e nëntë euro) në emër të rimbursimit të pagesës për dëmin e shkaktuar në aksidentin e datës 23.09.2012 nga i padituri, me kamatë ligjore siç e cila e aplikojnë bankat pa destinim të caktuar mbi një vit, si dhe shpenzimet për taksën për padi në shumë prej 30.00 € e deri në pagesën përfundimtare të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me forcë.

II. OBLIGOHET paditësja që të bëjë pagesën e përfaqësuesit të përkohshëm në shumë prej 239.00 € në afat prej 3 ditësh, në xhirollogarinë bankare të përfaqësuesit të përkohshëm [REDACTED] avokat nga Ferizaj.

Arsyetimi

Paditësja Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS) me seli në Prishtinë me datë 14.12.2015 ka paraqitur padi, me të cilën ka kërkuar nga i padituri t'ia paguaj shumën e cekur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 23.09.2012, ku si shkaktar i aksidentit është i padituri, i cili në momentin e shkakimit të aksidentit, ka qenë pa mbulesë siguruse, respektivisht me afat të skaduar të policës së sigurimit, nga i cili aksident, ka pësuar dëme në automjetin e dëmtuar [REDACTED] nga [REDACTED]

Përfaqësuesi i paditëses deklaroi se: mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë duke mbështetur në provat e pakontestueshme të cilat gjenden në shkresat e lëndës, i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj në tërësi si të bazuar dhe të detyrohet i padituri që në emër të rimbursimit të dëmit paditëses t'ia paguajë shumën prej 1,639.00 €, kamatën ligjore, taksën gjyqësore si dhe shpenzimet e tjera të procedurës.


Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, gjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshtojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses sepse kërkesa për rimbursimin e mjeteve është parashkruar, ngase kanë kaluar gati pesë vite nga data e lëshimit të marrëveshjes.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse i parashtruan ato në këtë procedurë, bazuar në nenin 7.1 të LPK-së, ka bërë administrimin e provave si vijon: *transferi i dëmshpërblimit i datës 19.03.2013 përmes Bankës Ekonomike; raporti i policisë nr.2012-CFT-558 i datës 23.09.2012; ujdia gjyqësore nr.1997/12 e datës 21.02.2013; vendimi me nr. FK-1997/12 i datës 14.12.2013; vendimi i i Fondit të kompensimit të shkallës së dytë, i datës 14.12.2012; formulari i kompensimit të dëmiy jo-material i datës 03.12.2012 dhe datës 14.12.2012; vlerësimi mjekësor në emër të [REDAKTUAR] nr.1997/2012 i datës 21.11.2012; kërkesa për dëmshpërblim e ushtruar nga [REDAKTUAR] i datës 12.11.2012; certifikata e lindjes në emër të [REDAKTUAR] me nr. reference: L.76/51 dhe nr. rendor 3146 i datës 12.11.2012; ankesa e ushtruar nga i autorizuari i të dëmtuarit e datës 05.09.2011; vendimi i shkallës së dytë i komisionit për trajtimin e dëmeve nr.1997/2012; fletëlëshimi nga QKUK Prishtinë nr.1943/562; përgjigja në padë e ushtruar nga përfaqësuesi i përkohshëm për të paditurin, e datës 03.01.2018.*

Bazuar në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës dhe vlerësimin të tyre, në kuptim të nenit 8 par.1 dhe 2 të LPK-së, Gjykata ka vërtetuar se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Gjykata nga shqyrtimi gjithëmbarshtëm i fakteve dhe provave të çështjes, ka gjetur se në mes palëve ndërgjyqëse nuk është kontestues se i padituri ka shkaktuar aksidentin e datës 23.09.2012 dhe se kontestuese është vetëm baza e kërkesëpadisë, sepse sipas përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit, kërkesa për rimbursimin e mjeteve është parashkruar.

Gjykata, pas administrimit të provave, ka bërë shqyrtimin e tyre veç e veç si dhe të ndërlidhura si tërësi mes veti, mbi bazën e bindjes së saj të lirë në kuptim të nenit 8 par.1 dhe 2 të LPK-së ka ardhur në përfundim se me rastin e leximit të dosjes nr.1997/2012, gjykata ka konstatuar se i dëmtuari përmes përfaqësuesit të tij ka parashtruar kërkesë për kompenzimin e dëmit të paditësjës, ku paditësjësja i'a ka kompenzuar dëmin në shumë prej 1,639.00 €, kjo vërtetohet nga Ujdia Jashtgjyqësore e lidhur në mes të paditëses dhe të dëmtuarit [REDAKTUAR] dhe transferi i mjeteve i cili është bërë përmes Bankës Ekonomike në Prishtinë 19.03.2013. Në bazë të ligjit nr.04/L-180 për Sigurimin e Autopërgjegjësisë, paditësjësja ka qenë e obliguar që këtë dëm t'ia kompenzojë të dëmtuarit dhe të njejtin të rimburojë nga shkaktari i aksidentit e që në këtë rast është i padituri si shkaktar i aksidentit, gjë që vërtetohet nga Raporti i Policisë nr.2012-CFT-558, i datës 23.09.2012, të cilave prova gjykata u'a falë besimin dhe i pranoi në tërësi si të vërteta.



Gjykata ka çmuar se, kërkesëpërdia e paditësës përkitazi me lartësinë e pretenduar ka themelësinë në prova materiale duke qenë se shuma objekt kontesti në këtë procedurë civile kontestimore është konstatuar dhe dokumentuar me fakte dhe prova, andaj për këto arsye i padituri është përgjegjës për të rimbursuar këtë dëm që paditësja ka qenë e detyruar fillimisht ta paguante ndaj personit që ka pësuar dëme nga aksidenti i shkaktuar nga i padituri dhe rrejdhimisht, i padituri ka detyrimin që këtë shumë t'ia rimbursion paditësës, në bazë të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve dhe Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia.

Lidhur me pretendimin e përfaqësuesit të përkoshëm të palës së paditur, se kërkesa për rimbursimin e mjeteve është parashkruar, Gjykata e ka vlerësuar këtë fakt dhe ka ardhur në përfundim se pretendimi i tillë është i pabazuar, ngase nga provat e administruara del se nuk kemi të bëjmë me parashkrim apo vjetërsim të kërkesës, sepse si fakt fillimit të rrjedhjes së afatit të parashkrimit merret data kur paditësja dhe i dëmtuari kanë lidhur Ujdi jashtë-gjyqësore për kompensimin e dëmit, ngase me rastin e lidhjes së Ujdisë, paditësja e ka vërtetuar shkaktimin e dëmit dhe e ka pranuar ekzistimin e demit, i cili moment konsiderohet si moment kur paditësja është vënë në dijeni të ekzistimit të dëmit. Gjykata nga ky fakt ka gjetur se nga data e arritjes së Ujdisë jashtëgjyqësore me datë 21.02.2013 e deri në datën e paraqitjes së padisë në gjykatë me datë 14.12.2015 kanë kaluar saktësisht 2 vite e 9 muaj dhe 21 ditë, prandaj sipas kësaj, Gjykata ka konstatuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 357 të LMD-së.

Andaj nga të theksuarat më lartë, gjykata konform nenit 2, 5, 29 dhe 143 të LPK-së dhe nenit 169 dhe 170 të LMD-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Lidhur me kompensimin e shpenzimeve për përfaqësuesin e përkoshëm, Gjykata e ka detyruar të padituren në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Gjykata lidhur me kamatën ka vendosur në bazë të nenit 382 par.2 të LMD-së ndërsa për shpenzimet e procedurës ka vendosë në bazë të nenit 452 par.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIYAJ

C.nr.792/15, me datën 23.01.2018

REPUBLIKA E KOSOVËS  REPUBLIKA KOSOVO

VENDIMI ËSHTË I PLOTËFUNDISHËM
ODLUKA JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD
FERIZAJ - II UROŠEVAC

Më Dana 09.03 2018



Gjyqtari,

Misin Frangu



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.